



Në selinë e partisë politike Aleanca Kosova e Re, kryetari i kësaj parti takoi Shefin e Zyrës Italiane z. Patrick Mura. Z. Pacolli e njoftoi për zhvillimet e brendshme në parti, orientimin politik dhe vizionin ekonomik të zhvillimit të Kosovës. “Me Italinë nuk kemi tani marrëdhënie bilaterale dhe protokolle të nënshkruara por jemi duke i përgatitur ato dhe duke punuar shumë që të gjejmë mundësinë të bëjmë një përgatitje shumë të

shpejtë të punëtorëve në Itali, që të punojnë atje pasi që kërkesat për një gjë të tillë veç ekzistojnë”, tha kryetari Behgjet Pacolli.

Në anën tjetër u shpreh se Italia, ashtu si të gjitha vendet e Grupit të Kontaktit në vazhdimësi po mendojnë dhe punojnë për të ardhmen e Kosovës, e cila nuk merr fund vetëm me përcaktimin e statusit por edhe pas saj, për problemet të cilat nuk do të zhduken menjëherë pas definimit të statusit siç janë ekonomia, zhvillimi i jetës politike, shoqërisë dhe demokracisë . “Ne e përshëndesim fillimin e punës së kësaj partie të re në Kosovë. Kjo është shenjë e shëndetshme sepse ardhja e partive të reja dëshmon shprehjen e interesave të reja politike. Në të ardhmen, do të zhvillohen edhe zgjedhjet në Kosovë dhe do të jetë vendim i popullit të Kosovës për të ardhmen e saj”, deklaroi z. Mura.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan se statusi duhet të zgjidhet në kohë sa më të shpejtë dhe se nuk duhet të ketë shtyrje të mëtejshme të bisedave për statusin e Kosovës